

KREU I PARË

Anxheloja u zgjua befas në agim i kënaqur e i heshtur. Lartësia e kodrës e kishte mbrojtur prej asaj pak vese që bie verës në këto vise. E kashaisi kalin me një dorë shqopë dhe mbështolli çantën prej cope.

Zogjtë po zgjoheshin në luginën e vogël ku po zbriste. S'bënte fresk as poshtë thellë luginës ende të mbuluar prej territ të natës. Qielli ishte ndriçuar tejmbanë prej shigjetash drite të përhimë. Më në fund, një diell i kuq, i copëtuar i tëri nëpër degëzime resh të errëta, lindi nga pyjet.

Me gjithë vapën, që ishte bërë mbytëse, Anxheloja kishte etje të madhe për diçka të ngrohtë. Ndërsa po dilte nga lugina ku kishte kaluar natën, midis kodrave dhe një masivi më të lartë e të egër që shtrihej nja dy lega përpara, mbi të cilin rrezet e para të diellit përndrisnin broncin e lisave të gjatë, ai pa buzë rrugës një fermë të vogël gjysmatari, dhe, në livadh, një grua me fund të kuq që po mblidhte ndërresat e nderura.

U afrua. Gruaja i kishte supet dhe krahët të zhveshur dhe po kështu edhe gjoksin e madh të nxirë nga dielli që i dukej jashtë jelekut. - Më falni, zonjë, - tha, - a mund të më jepni pak kafe? Jua paguaj. - Ajo nuk u përgjigj menjëherë dhe ai e kuptoi se kishte folur me shumë delikatesë. "Po edhe atë *Jua paguaj* e thashë me ngathtësi", - tha me vete. - Ejani, - i tha ajo. - Po ju bëj një kafe. - Ajo ishte e gjatë po me një trup aq të ngjeshur sa u kthye ngadalë rreth vetes si ndonjë anije. - Dera është atje, - i tha duke i treguar cepin e gardhit.

Në kuzhinë ishte vetëm një plak dhe shumë miza. Megjithatë, mbi stufën e ulët të nxehur mirë nga zjarri, pranë një kazani me krunde për derrat, ibriku i kafesë lëshonte një erë aq të mirë sa Anxhelos ajo kuzhinë e nxirë nga bloza iu duk e këndshme sa s'ka. Edhe kazani me krunde për derrat i fliste një gjuhë shumë tërheqëse stomakut të tij të pakënaqur nga një darkë me bukë thatë.

Piu një filxhan kafe. Gruaja, që po i rrinte përballë, së cilës i shihte supet e mbushur plot gropëza e madje edhe thithat e mëdhenj mavi të gjinjve, e pyeti se mos ishte ndonjë zotëri nga prefektura. “Kujdes, - tha Anxheloja me vete. - Po pendohet që më dha kafe”. - Oh, jo, - tha, (duke bërë kujdes ta shmangte fjalën zonjë); - jam tregtar nga Marseja. Po shkoj në Drom, ku kam klientë. Ndërkohë po përfitoj të marr pak ajër fshati. - Fytyra e gruas u bë më e përzemërt, sidomos kur ai pyeti për rrugën që të çonte në Banon. - Po ju bëj një vezë, - i tha. E shtyu kazanin e krundeve dhe vuri tiganin në zjarr.

Ai hëngri vezën dhe një copë sallo me katër feta buke të një çyreku të madh e të bardhë që iu dukën të lehta pendë. Gruaja tani i vinte rrotull si ndonjë nënë. Ai u habit me veten që nuk u pështiros nga era e djersës dhe nga qimet e dendura të kuqe të sqetullave të saj që iu dukën kur ngriti krahët të rregullonte flokët e mbledhura topuz.

Ajo s’pranoi të paguhej e madje filloi të qeshte se ai ngulte këmbë, dhe ia shtyu kuletën pa e zgatur. Anxhelos i erdhi plasje që u tregua aq i ngathët e qesharak: do të kishte dashur të paguante e të mund të largohej me atë pamjen e ftohtë e të shkujdesur që e kishte si mburojë për druajtjen e vet. Tha me të shpejtë ca fjalë falënderimi dhe e futi kuletën në xhep.

Gruaja i tregoi rrugën, që ngjitej në lisnajë nga ana tjetër e luginës. Anxheloja eci një copë herë të mirë në heshtje, në një fushë të vogël nëpër livadhe në një të gjelbër të fortë. Ato që kishte ngrënë i kishin lënë në gojë një shije shumë të këndshme, që vazhdonte ta ndiente. Më në fund psherëtiu e ia dha kalit me trok.